



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë, më 25.05.2026

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

LOTI NR.2 “BLERJE BENZINE PREMIUM UNL PER MJETET E BASHKISE
KRUJE”

PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 25.05.2026 , ne Kruje ,nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me **urdherin nr.226 datë, 25.05.2026** me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit ‘E Hapur’, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: LOTI NR.2 “BLERJE BENZINE PREMIUM UNL PER MJETET E BASHKISE KRUJE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- (Hidrokarburet-24321000-0)/ Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 123’000 (njqind e njezet e tre mije) lekë pa t.v.sh

BURIMI I FINANCIMIT: Te ardhurat e Bashkisë Krujë +Transferat Specifike sipas programeve buxhetore te miratuara me VKB nr.10 date 22.04.2026 .

LLOJI I PROCEDURES:PROCEDURE E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTE MONETAR

LLOJI I KONTRATES: MALLRA

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; (Ne raportin prej 2% te vleres se fondit limit te kontrates/lotit qe prokurohet)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2026 per secilin operator).

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2026 te leshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka seline si dhe ushtron aktivitet sipas QKB ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2026 per secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

b)-Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë/autorizim/leje (të vlefshme), për tregtimin me pakicë ose shumice , të karburanteve në përputhje me Ligjin Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar , dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar :

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.1.a)-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit te **kontrates/ lotit nr.2** dhe perkatesisht ne shumen prej **49'200(dyzet e nente mije e dyqind) leke pa t.v.sh .**

- **Shenim-Pika 2.2.1-b)** plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nen kufirin e ulet monetar dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të permbushur me sukses kontratën

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3-1) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit nr.2**, që prokurohet dhe perkatesisht ne **shumen prej 24'600(njzet e kater mije e gjashteqind) leke pa t.v.sh .**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2-Subjekti ofertues duhet të disponojë/zotërojë minimalisht 1(një) stacion të tregtimit/te shitjes me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Krujë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil, për të cilin duhet të paraqesi:

a)(kontratën e qerese/perdorimi të vlefshme) , ose Certifikatë pronësie/,ose të jete/në të pasqyruar në ekstraktin tregtar të QKB të operatorit ekonomik pjesmarrës).

b)Liçensën e stacionit për tregtimin/shitjen me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë (e vlefshme) lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje dhe në zbatim

të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre ”i ndryshuar dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar :

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj” dhe Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “ Për lejet e mjedisit”.

Duke qenë se Bashkia Krujë ka një numër të konsiderueshem mjetesh(perfshire edhe mjete te sherbimit te natyres emergjente te MZSH, Emergjencave civile, Bordi i Kullimit) , do te ishte e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 stacione të tregtimit me pakicë të karburantit ne territorin e Bashkise Kruje , jo vetem per disponibilitetin e furnizimit ne raste te veprimtarive operative te mjeteve sidomos ne raste emergjence civile apo nderhyrje per hapje rruges ne raste situata te veshtira atmosferike , por i sherben edhe edhe minimizimit e kostove te konsumit te karburantit

2.3.3-Operatori ekonomik duhet të jetë paraqesë raport analize të lëshuar nga Autoriteti shtetëror kompetent inspektues sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, për produktin **Benzinë pa plumb Standard SSHEN 228:2025 ose ekuivalent** , ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza nga autoriteti kompetent shtetëror duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me

nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, VKM nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”. Raport analiza e karburantit, është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilësinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo garanci, lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve të tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë, i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për ofrimin e karburantit cilësor. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj duke përmbushur edhe specifikimet teknike, është kërkuar që të paraqitet raport analizimi për cilësinë e karburantit, lëshuar nga organi përkatës.

2.3.4-Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) qe provon se subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje te cilësisë për vitin e fundit.

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK, që OE ofertues nuk është penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e karburanteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr.491, datë 19.7.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.3.5 : Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë(vetedeklarim nga administratori/perfaqesuesi ligjor i operatorit ekonomik ofertues):

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistolete publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsiper që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në karten elektronike deri në përfundimin/ezuarimin e plotë të kontratës sipas nevojave të autoritetit kontraktor.Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar sipas adresave të Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “ Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operoret ekonomik pjesmerës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage) që ofron çdo operator ekonomik pjesmarrës përben shkak për skualifikim.

Argumentim: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM-në Nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar si dhe të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe nenit 40, pika 8, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë asetet elektronike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.3.6-)Operoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen

e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin Rregullave të Prokurimit Publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e artikullit të mesiperm është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Sherbimeve dhe Investimeve Publike që mban **nr. _____ Prot, date _____, 2026** duke identifikuar specifikimet standarte dhe karakteristikat perkatëse teknike të cilat plotësojnë nevojat respektive të Bashkisë Krujë sipas kërkesave të Ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre ‘’.

Sa i përket standartit të specifikimeve teknike ato janë hartuar duke marrë në konsideratë përcaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit të pranuar të tregut si dhe kërkesat perkatëse të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tabela mbi standartin e lëndës Benzine pa plumb, SSH EN 228:2025 ose ekuivalent "Lëndët djegëse për automjete – Benzinë pa plumb

Karakteristika	Njësia	Kufiri	Metoda prove (EN/ISO)
Numri i oktanit (RON)	-	$\geq 95 / \geq 98$	EN ISO 5164
Numri i oktanit (MON)	-	≥ 85	EN ISO 5163
Përmbajtja e plumbit	g/L	≤ 0.005	EN 237
Dendësia në 15°C	kg/m ³	720 – 775	EN ISO 12185 / EN ISO 3675
Presioni i avullit (RVP)	kPa	45 – 60*	EN 13016-1 / EN 13016-2
Distilim – T10	°C	≤ 70	EN ISO 3405
Distilim – T50	°C	≤ 120	EN ISO 3405
Distilim – T95	°C	≤ 210	EN ISO 3405
Rezidui	% v/v	≤ 2	EN ISO 3405
Stabiliteti oksidativ	min	≥ 360	EN ISO 7536
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	≤ 10	EN ISO 20846 / EN ISO 20884

Përmbajtja e benzenit	% v/v	≤ 1.0	EN ISO 22854
Aromatikët	% v/v	≤ 35	EN ISO 22854
Olefinat	% v/v	≤ 18	EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit	% m/m	≤ 3.7	EN ISO 22854
Etanoli	% v/v	≤ 10	EN 13132
Metanoli	% v/v	≤ 3.0	EN 13132
Stabiliteti ndaj oksidimit	min	≥ 360	EN ISO 7536
Goma ekzistuese (gum content)	mg/100 ml	≤ 5	EN ISO 6246

Argumentim: Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. **AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

- **Fondi limit** per proceduren me objekt , **Loti nr.2 ‘Blerje Benzine Premium Unl per mjetet e Bashkise Kruje’** eshte hartuar duke iu referuar 45.2/1 dhe 76.1. te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK